




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 20/DPK	Br. Prot. 01-4914/14
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages 02	Date 19.12.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4270-14 për z.*Bujar Hasani* – Anëtar i Bordit në K.R.U. “Hidrogjeni Jugor” sh.a. Prizren, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4270-14, për Zyrtarin e lartë, z.Bujar Hasani–Anetar i Bordit ne K.R.U. “Hidrogjeni Jugor” sh.a. Prizren dhe njëkohësisht person i autorizuar në një ndërmarrje private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Hasani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-4468-14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Hasani është deklaruar se shumë shpejt do t’i bëjë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, z.Hasani, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-4876/14) “Informata mbi biznesin” nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i të qenurit person i autorizuar i biznesit N.T.SH.”Mob” duke emruar një person të besuar në këtë funksion.

Tani, z.Hasani, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Anetar i Bordit në K.R.U. Hidrogjeni Jugor” sh.a. në Prizren.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
Hasan Preteni

